

PLATFORMA PER PRONAT

Kryesia e Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”

Për shkak të mungesës së plotë të vullnetit politik të politikanëve të forcave politike kryesore për ta kthyer fizikisht pronën tek i zoti, zgjidhja definitive e anarkisë së titujve të pronësisë kërkon vullnetin politik të institucioneve ndërkombëtare. Korrupsioni me pronat i intereson njëloj si Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike, pasi **politikanët dhe qeveritarët kanë miratuar ligje me të cilat kanë përfituar tokat që regjimi i diktaturës i shpalli prona të shtetit**. Pushtetarët dhe politikanët nuk dëshirojnë të heqin dorë nga ato prona që pas vitit 1991 kanë përfituar nga qënia e tyre në pushtet. Ky është shkaku pse lufta politike për pushtet në Shqipëri është më e ashpër se kudo, pse opozita flet vetëm për manipulim të zgjedhjeve dhe nuk flet për faktin se nga 1991 e deri sot nuk janë kthyer akoma pronat që janë të patjetërsuara dhe ndodhen në të njëjtën gjendje që kanë qenë në kohën e shtetëzimit komunist. **Nuk është shpallur pavlefshmëri për aktet e kryera në shkelje me ligjet egzistuese**. P.sh. neni 2 i ligjit 8053 përcakton qarte se tokat e ish Ndërmarrjeve Bujqësore që ndodhen në zonat turistike, ju kthehen të shpronësuarve. Ky nen nuk është zbatuar megjithë kërkesat tona të përsëritura. Neni 181/2 i Kushtetutës vazhdon të shkelet. **Janë të shumta rastet kur vendimet e formës së prerë të Gjykatave, madje edhe të Gjykatës së Strasburgut nuk zbatohen**. Çdo ditë që kalon anarkia e pronës thellohet sepse politikanët e të dy krahëve janë të interesuar ta ngatërojnë sa më shumë problemin. Në këto kushte kërkesa për zgjedhje të lira dhe të ndershme, kërkesa për luftë kundër korrupsionit dhe kërkesa për sistem juridik të pavaruar nuk mund të realizohen pa zgjidhur më parë kthimin e pronës tek i zoti.

Mundësia për një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme egziston. Zgjidhja kërkon që institucionet ndërkombëtare të kushtëzojnë dhe të vendosin si parakusht në marrëdhëniet dhe në mbështetjen që i japin politikës shqiptare që **problemi i pronës të zgjidhet në përputhje me nenin 181 të Kushtetutës në fuqi dhe në përputhje me konventën dhe kjo të jetë detyrim i shtetit**. Të kërkohet që shteti që i disponon të gjitha mundësitë dhe dokumentat të ndajë dhe të dallojë cilat prona i përkasin shtetit dhe cilat prona shteti komunist ja ka shtetëzuar qytetarëve. Të përcaktohet një afat për përfundimin e procesit të kthimit fizik, duke përcaktuar edhe një afat të shkurtër kohor dhe pas përfundimit të kthimit fizik të fillojë procesi i kompensimit. Deri në përfundimin e kthimit dhe kompensimit duhet të shpallen të ngrira (moratorium) për proceset e legalizimit të ndërtimeve të kundraligjshme.

Institucionet ndërkombëtare, duhet të imponojnë Qeverinë Shqiptare që me procedurë të shpejtuar të hartojë një ligj ku **të realizohen këto kërkesa:**

1. Zgjidhja e problemit të pronës dhe reforma e pronës në përputhje me kërkesat e Këshillit të Europës (Neni 191 të dokumentit nr 11115 datë 20 Dhjetor 2006 të Asamblesë parlamentare të KE), sipas detyrimeve kushtetuese dhe sipas titujve të mirfilltë të pronësisë të pranohet me ligj si detyrimi i qeverise dhe shtetit. Ky process duhet të ndahet në dy faza të veçanta: faza e kthimit dhe pas përfundimit të kthimit fizik të fillojë kompensimi.
2. Qeveria të ndajë dhe dallojë se cilat janë prona ku shteti gëzon ligjërisht titujt e mirfilltë të pronësisë dhe cilat janë prona që Shteti i diktaturës ju grabiti pronarëve të ligjshëm dhe që duhet tu kthehen fizikisht të zotërve. Nga pronat e shtetëzuara nuk kthehen tek i zoti por kompensohen ato prona që janë tjetërsuar për ndërtime banimi para vitit 1991 ose vazhdojnë edhe sot të shfrytëzohen për nevoja publike konform ligjit
3. Nga organet shtetërore të shpallen të pavlefshme të gjitha aktet me të cilat drejtuesit e institucioneve shtetërore, pas vitit 1991, e kanë transferuar pronën e subjekteve të shpronësuar në persona të tretë.
4. Të përcaktohet një afat kohor për kthimin fizik (rikthimi i të drejtës së posedimit) të pronave të trashëguara, në kufijtë e tyre sipas dokumentave zyrtare të para vitit 1945, që vetë shteti I zotëron.
5. Kthimi të bëhet konform Kodit Civil: d.m.th. prona i kthehet trungut familjar të trashëgimlënësit, pronar i ligjshëm, grup pronarësh apo institucioni fetar dhe jo vetëm trashëgimtarëve që jetojnë në fshat..
6. Kthimi fizik i pronës të bëhet në bazë të dokumentave të para kolektivizimit komunist dhe jo sipas zërit kadastral apo llojit të pronës: tokë bujqësore, kullotë, livadh, truall, pyll etj., dhe jo kthim fizik vetëm trashëgimtarit që jeton në fshat.
7. Pronarëve të vërtetë tu kthehet plotësisht prona dhe e drejta e parablerjes së objekteve të ngritura mbi tokat e tyre dhe të privatizuara me mënyra korruptive nga Qeveria siapas interesave klanore, duke shpallur të pavleshme tjetërsimet që bien ndesh me të drejtën e pronës dhe të pronësisë të përcaktuar në nenin 181 të Kushtatutës.
8. Të llogaritet masa për çdëmtim ose sipas rastit vlerësim financiar, personave të tretë, që pas vitit 1991 i kanë përfituar padrejtësisht dhe po i shfrytëzojnë pronat e pronarëve të mirfilltë dhe pronat e mirfillta të shtetit.
9. Pas përfundimit të kthimit të fillojë faza e kompensimit. Kompensimi të bëhet me prona të mirfillta të shtetit, bëhet njëherësh dhe me çmimin aktual te tregut. Sipas të dhënave zyrtare (ato shtetërore dhe ato të Bankës Botërore) pronat shtetërore përbëjnë 52% të pronës.
10. Hartat e tokave të lira dhe hartat e çmimeve, janë të nevojshme vetëm për fazën e kompensimit dhe mund të hartohen vetëm pas përfundimit të kthimit. Kompensim të parashikohet vetëm për pronat që vazhdojnë të

shfrytëzohen për nevoja publike. Këto nuk përbëjnë asnjë problem sepse janë shumë pak dhe Shteti, si pronar i mirëfilltë i 52% të pronave në Shqipëri, disponon mjaftueshëm (dhe i teprojnë) prona për të kompensuar shumë herë më tepër nga sa janë nevojat reale, pa krijuar deficite financiare për të cilat të gjithë shqiptarët duhet të paguajnë për më shumë se 1000 vjet. Kompensimi që ka filluar të zbatohet synon të maskojë transferimin e paligjshëm të pronave të bërë pas vitit 1991 në interes të klaneve të oligarkisë së politikanëve.

11. Platforma e deritanishme ka keqpërdorur fondet e USAID, FMN dhe të Bankës Botërore të dhëna për regjistrimin e pasurive të paluajtëshme. Korigjimi bëhet duke kërkuar që korigjimi i gabimeve me pronën të fillojë me ZRPP duke shtuar në regjistrat aktualë një rubrikë të re që të përcaktojë origjinën e pronës para kolektivizimit komunist. Pastaj shteti të shpalli të pavlefshme ato pjesë të atyre akteve sipas të cilave prona nuk i është kthyer trungut familjar të pronarit por është transferuar pa të drejtë tek persona të tretë . Shteti i disponon të gjitha dokumentat dhe institucionet që të përcaktojë se e kujt ka qenë prona. Në rastet kur pronari që i kthehet prona, ka kontestime, ky vendim i drejtohet shqyrtimit nga gjykata.

Nese zbatohet kjo platformë prona kthehet tek i zoti, mbyllet ky burim i madh i korrupsionit politik dhe ekonomia e vendit shpëton nga një barrë e papërballushme ekonomike.

Për kryesinë e Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve
“Pronësi me Drejtësi”

Rrapo Hajredin Danushi

Adresa: E-mail: pronesi_me_drejttesi@yahoo.com
Tel. 033224883

22. 09.2010.